

STANDARDI NDËRKOMBËTAR I AUDITIMIT 510

ANGAZHIMET FILLESTARE TË AUDITIMIT—TEPRICAT E ÇELJES

(Ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date)

PËRMBAJTJA

	Paragrafi (ët)
Hyrje	
Objekti i këtij SNA-je	1
Data e hyrjes në fuqi	2
Objektivi	3
Përkufizimet	4
Kërkesat	
Procedurat e Auditimit	5–9
Konkluzionet e Auditimit dhe Raportimi	10–13
Zbatimi dhe Materiale të Tjera Shpjeguese	
Procedurat e Auditimit	A1–A7
Konkluzionet e Auditimit dhe Raportimi	A8–A9
Shtojcë: Ilustrime të Raportit të Auditimit me Opinion të Modifikuar	

Standardi Ndërkombëtar i Auditimit (SNA) 510 “Angazhimet Fillestare të Auditimit - Tepricat e çeljes” duhet të lexohet i lidhur ngushtë me Standardin Ndërkombëtar të Auditimit (SNA) 200 “Objektivat e Përgjithshme të Audituesit të Pavarur dhe Kryerja e një Auditimi në Pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit”.

Hyrje

Qëllimi i këtij SNA-je

1. Ky Standard Nërkombëtar i Auditimit (SNA) trajton përgjegjësitë e audituesve lidhur me tepricat e çeljes në një angazhim auditimi që kryhet për herë të parë. Përveç shumave të pasqyrave financiare, tepricat e çeljes përfshijnë edhe çështje që kërkojnë dhënie informacioneve të cilat kanë egzistuar në fillim të periudhës, të tilla si kontigjencat dhe angazhimet. Kur pasqyrat financiare përfshijnë informacion financiar krahasues do të zbatohen edhe kërkesat dhe udhëzimet që jepen në SNA 710¹. SNA 300² përfshin kërkesa dhe udhëzime shtesë lidhur me aktivitetet përpara nisjes së një auditimi fillestar.

Data e hyrjes në fuqi

2. Ky SNA ka hyrë në fuqi për auditimet e pasqyrave financiare për periudhat që kanë filluar me datën 15 Dhjetor 2009 ose pas kësaj date.

Objektivi

3. Në kryerjen e një angazhimi auditimi fillestar, objektivi i audituesit lidhur me tepricat e çeljes është të marrë evidence auditimi të nevojshme për faktin nëse:
 - (a) Tepricat e çeljes përmbajnë anomali të cilat kanë efekt material në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, dhe
 - (b) Politikat kontabël të reflektuara në tepricat e çeljes janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, ose ndryshimet në to janë kontabilizuar dhe paraqitur në mënyrë të përshtatëshme, dhe për to janë dhënë informacionet shpjeguese në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Përkufizimet

4. Për qëllime të SNA-ve, termat e mëposhtëm kanë kuptimet që ju janë dhënë në vijim:
 - (a) Angazhimet fillestare të auditimit - Një angazhim në të cilin:
 - (i) Pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme nuk janë audituar, ose
 - (ii) Pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme kanë qënë audituar nga një auditues paraardhës.

¹ SNA 710, *Informacioni Krahasues—Shifrat Korrespoduese dhe Pasqyrat Financiare Krahasuese.*

² SNA 300, *Planifikimi i një Auditimi të Pasqyrave Financiare.*

- (b) Tepricat e çeljes - Tepricat e llogarive, që ekzistojnë në fillim të periudhës. Tepricat e çeljes bazohen tek tepricat e mbylljes së llogarive të periudhës paraardhëse dhe reflektojnë efektet e transaksioneve dhe ngjarjeve të periudhave paraardhëse dhe politikat kontabël të zbatuara në periudhën paraardhëse. Tepricat e çeljes përfshijnë gjithashtu, çështjet që kërkojnë dhenien e informacioneve shpjeguese që ekzistojnë në fillim të periudhës, siç janë kontigjencat dhe angazhimet.
- (c) Audituesi paraardhës - Audituesi nga një firmë tjetër auditimi, i cili ka audituar pasqyrat financiare të një entiteti në periudhën e mëparshme, dhe që në periudhën aktuale është zëvendësuar nga audituesi aktual.

Kërkesat

Procedurat e Auditimit

Tepricat e çeljes

5. Audituesi duhet të lexojë pasqyrat financiare më të fundit, nëse ka, dhe raportin e audituesve paraardhës, nëse ka, për të siguruar informacione që lidhen me tepricat e çeljes, përfshirë informacionet shpjeguese.
6. Audituesi duhet të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit për faktin nëse tepricat e çeljes përmbajnë anomali të cilat ndikojnë në mënyrë materiale pasqyrat financiare të periudhës aktuale, nëpërmjet: (Ref: Para. A1-A2)
 - (a) Përcaktimit nëse tepricat e mbylljes të periudhës paraardhëse janë mbartur në mënyrë korrekte në periudhën aktuale ose, kur është kërkuar, janë riparuar në mënyrën e duhur;
 - (b) Përcaktimit nëse tepricat e çeljes reflektojnë zbatimin e duhur të politikave kontabël; dhe
 - (c) Kryerjes të një ose disa prej procedurave të mëposhtme: (Ref: Para. A3-A7)
 - (i) Rishikimit të fletëve të punës të audituesit paraardhës për të marrë evidencë lidhur me tepricat e çeljes; kur pasqyrat financiare të periudhës paraardhëse kanë qënë audituar,
 - (ii) Vlerësimin nëse procedurat e auditimit të kryera në periudhën aktuale japin evidencën përkatëse për tepricat e çeljes; ose
 - (iii) Kryerjes së procedurave të auditimit specifike për të marrë evidencën lidhur me tepricat e çeljes.
7. Në qoftë se audituesi merr evidencë auditimi që tregon se tepricat e çeljes përmbajnë

anomali të cilat mund të ndikojnë në mënyrë materiale në pasqyrat financiare të periudhës, ai duhet të kryejë ato procedura auditimi shtesë që janë të përshtatshme për rrethanat, për të përcaktuar efektin në pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se këto anomali egzistojnë në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, ai duhet t'i komunikojë anomalitë tek niveli përkatës i drejtimit dhe tek personat e ngarkuar me qeverisjen në përputhje me SNA 450.³

Qëndrueshmëria e Politikave Kontabël

8. Audituesi duhet të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit për faktin nëse politikat kontabël të reflektuara në tepricat e çeljes janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në pasqyrat financiare të periudhës aktuale, dhe nëse ndryshimet në politikat kontabël janë kontabilizuar dhe paraqitur në mënyrën e duhur dhe mjaftueshëm dhe nëse janë dhënë informacionet shpjeguese në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar.

Informacioni i Përshtatshëm në Raportin e Audituesit Paraardhës

9. Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar nga një auditues paraardhës dhe për to është bërë një modifikim i opinionit, audituesi duhet të vlerësojë efektin e çështjeve që kanë çuar në këtë modifikim kur ai vlerëson rreziqet e anomalisë materiale në pasqyrat financiare të periudhës aktuale në përputhje me SNA 315 (i rishikuar).⁴

Konkluzionet e Auditimit dhe Raportimi

Tepricat e çeljes

10. Nëse audituesi nuk ka qënë në gjendje të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me tepricat e çeljes, sipas rrethanave, ai duhet të shprehë një opinion me rezervë ose të heqë dorë nga dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare, në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).⁵ (Ref: Para. A8)
11. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se tepricat e çeljes përmbajnë anomali të cilat prekin në mënyrë materiale pasqyrat financiare të periudhës aktuale dhe efekti i anomalive nuk është paraqitur ose shpjeguar siç duhet, audituesi, në varësi të rrethanave, do të shprehë një opinion me rezervë ose të heqë dorë nga dhënia e opinionit në përputhje me SNA 705.

Përshtatshmëria e Politikave Kontabël

³ SNA 450, *Vlerësimi i anomalive të identifikuara gjatë auditimit*, paragrafët 8 dhe 12.

⁴ SNA 315 (i rishikuar), *Identifikimi dhe Vlerësimi i Rreziqeve të Anomalisë Materiale Nëpërmjet Njohjes së Entitetit dhe Mjedisit të tij*.

⁵ SNA 705 (i rishikuar), *Modifikimet e Opinionit në Raportin e Audituesit të Pavarur*.

12. Nëse audituesi arrin në konkluzionin se:

- (a) politikat kontabël të periudhës aktuale në lidhje me tepricat e çeljes nuk janë zbatuar siç duhet në pajtim me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar; ose
- (b) një ndryshim në politikat kontabël nuk është kontabilizuar ose paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të mjaftueshme ose për të nuk janë dhënë informacionet shpjeguese në përputhje me kuadrin e zbatueshëm të raportimit financiar,

audituesi, në varësi të rrethanave, duhet të shprehë një opinion me rezervë ose një opinion kundër në përputhje me SNA 705 (i rishikuar).

Modifikimi i opinionit në Raportin e Audituesit Paraardhës

13. Nëse opinionin e audituesit paraardhës lidhur me pasqyrat financiare të periudhës paraardhëse, ka përfshirë një modifikim në opinion, i cili vijon të mbetet i përshtatshëm dhe material edhe për pasqyrat financiare të periudhës aktuale, audituesi duhet të modifikojë opinionin për pasqyrat financiare të periudhës aktuale në pajtim me SNA 705 (i rishikuar) dhe SNA 710 (Ref: Para. A9)

* * *

Zbatimi dhe Materiale të tjetra shpjeguese

Procedurat e Auditimit

Konsiderata të veçanta për Entitetet e Sektorit Publik (Ref: Para. 6)

- A1. Në sektorin publik, mund të ketë kufizime ligjore ose rregullatore mbi informacionin që audituesi mund të marrë prej audituesit paraardhës. Për shembull, nëse një entitet i sektorit publik që është audituar më parë nga një auditues i caktuar në mënyrë ligjore, (për shembull një Auditues i Përgjithshëm, ose persona të tjerë të përshtatshëm të kualifikuar, të caktuar në emër të Audituesit të Përgjithshëm) është privatizuar, madhësia e aksesit në fletët e punës ose në informacionet e tjera, të cilat audituesi i caktuar ligjërisht mund t'i japë audituesi të ri që është në sektorin privat, mund të kufizohet nga ligjet ose rregulloret e ruajtjes së privacisë ose të sekretit. Në situatat kur ka kufizim të komunikimeve, evidenca e auditimit duhet të merret përmes mënyrave të tjera dhe, kur evidenca e nevojshme e auditimit nuk mund të merret, këto fakte duhet të reflektohen në opinionin e audituesit.
- A2. Nëse audituesi i caktuar ligjërisht nënkontraktin një auditim të një entiteti të sektorit publik, tek një firmë auditimi e sektorit privat, dhe audituesi i caktuar ligjërisht cakton një firmë auditimi të ndryshme nga firma që ka audituar pasqyrat financiare të entitetit të sektorit publik në periudhën paraardhëse, kjo zakonisht nuk konsiderohet si një ndryshim i audituesit për audituesin e caktuar

ligjërisht. Gjithsesi, në varësi të natyrës së marrëveshjes, angazhimi i auditimit mund të konsiderohet si një angazhim auditimi fillestar nga prespektiva e audituesit të sektorit privat në kuptimin e përmbushjes së përgjegjësisive të audituesit, dhe si rrjedhojë do të zbatohet ky SNA.

Tepricat e çeljes (Ref: Para. 6(c))

- A3. Natyra dhe shtrirja e procedurave të auditimit të nevojshme për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit për tepricat e çeljes varet nga çështje të tilla si:
- Politikat kontabël të ndjekura nga entiteti.
 - Natyra e tepricave të llogarive, klasave të transaksioneve dhe informacioneve shpjeguese të dhëna dhe rreziqeve të anomalisë materiale në pasqyrat financiare të periudhës aktuale.
 - Rëndësia relative e tepricave të çeljes në pasqyrat financiare të periudhës aktuale.
 - Fakti nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar dhe, nëse është kështu, fakti nëse opinioni i audituesit parardhës ka qënë i modifikuar.
- A4. Nëse pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme janë audituar nga një auditues paraardhës, audituesi mund të jetë në gjendje të marrë evidencën e nevojshme të auditimit për tepricat e çeljes përmes rishikimit të fletëve të punës të audituesit paraardhës. Fakti nëse një rishikim i tillë jep evidencën e nevojshme të auditimit influencohet nga kompetenca profesionale dhe pavarësia e audituesit paraardhës.
- A5. Kur komunikon me audituesin paraardhës, audituesi duhet të mbajë parasysh udhëzimet e kërkesave etike dhe profesionale.
- A6. Për aktivet dhe pasivet afatshkurtra, një pjesë e evidencës së auditimit për tepricat e çeljes mund të merret si pjese e procedurave të auditimit të periudhës aktuale. Për shembull, arkëtimi (pagesa) e tepricave të çeljes të llogarive të arkëtueshme (llogarive të pagueshme) gjatë periudhës aktuale jep evidence auditimi për ekzistencën e tyre, për të drejtat dhe detyrimet, plotësinë, dhe vlerësimin e tyre në fillim të periudhës. Megjithatë, në rastin e inventarëve procedurat e auditimit të periudhës aktuale mbi gjendjen e inventarit në mbyllje të periudhës japin pak evidence auditimi lidhur me gjendjen e inventarit në fillim të periudhës. Si rrjedhojë, kryerja e procedurave të auditimit shtesë dhe një apo disa prej procedurave të mëposhtme mund të sigurojë evidencën e nevojshme të auditimit:
- Vëzhgimi i numërimit fizik të inventarit aktual dhe rakordimi i tij me sasitë e inventarit në fillim.
 - Kryerja e procedurave të auditimit për vlerësimin e zërave të inventarit në çelje.

- Kryeja e procedurave të auditimit mbi fitimin bruto dhe rregjistrimin në periudhën e duhur (cutt off).

A7. Për aktivet dhe pasivet afatgjata, të tilla si aktivet afatgjata materiale, investimet, detyrimet afatgjata, një pjesë e evidencës së auditimit mund të merret duke ekzaminuar rregjistrimet kontabël dhe informacionet e tjera mbi të cilat bazohen tepricat e çeljes. Në disa raste, audituesi mund të jetë në gjëndje të marrë evidence auditimi lidhur me tepricat e çeljes, nëpërpjet konfirmimeve nga palët e treta, për shembull, për detyrimet afatgjata dhe investimet. Në raste të tjera, audituesit mund ti nevojitet të kryejë procedura auditimi shtesë.

Konkluzionet e Auditimit dhe Raportimi

Tepricat e çeljes (Ref: Para. 10)

A8. SNA 705 (i rishikuar) vendos kërkesa dhe jep udhëzime mbi rrethanat të cilat mund të cojnë në një opinion të modifikuar në raportin e auditimit mbi pasqyrat financiare, për llojin e opinionit të përshtatshëm sipas rrethanave, dhe për përmbajtjen e raportit të auditimit kur opinionit i audituesit është i modifikuar. Pamundësia e audituesit për të marrë evidence auditimi të nevojshme lidhur me tepricat e çeljes mund të rezultojë në një nga modifikimet e mëposhtme të opinionit në raportin e audituesit:

- (a) Një opinion me rezervë ose një refuzim për të dhënë opinion, të përshtatshëm në varësi të rrethanave; ose
- (b) Përveçse kur ndalohet nga ligji apo nga ndonjë rregullore tjetër, një opinion i cili është me rezervë ose një refuzim për të dhënë opinion, sipas rastit, lidhur me rezultatet e operacioneve, dhe flukset e parasë, kur konsiderohet e përshtatshme, dhe një opinion i pa modifikuar lidhur me pozicionin financiar.

Aneksi përfshin raporte ilustruese të audituesit.

Modifikim i Opinionit në Raportin e Audituesit Parardhës (Ref: Para. 13)

A9. Në disa situata, një opinion i modifikuar në raportin e audituesit parardhës mund të mos jetë i përshtatshëm dhe material për opinionin mbi pasqyrat financiare të periudhës aktuale. Ky mund të jetë rasti kur, për shembull, ka patur kufizim të objektit në periudhën paraardhëse, por çështja që ka çuar në kufizimin e objektit në periudhën aktuale është zgjidhur.

Ilustrime të Raporteve të Audituesve me Opinione të Modifikuara

Shënim: Në të gjitha këto raporte audituesi, ilustruese, në pajtim me SNA 700 (i rishikuar), seksioni i opinionit është zhvendosur në fillim të raportit dhe seksioni i Bazës për opinionin është pozicionuar menjëherë pas seksionit të opinionit. Gjithashtu, fjalia e parë dhe e fundit që u përfshi në seksionin e përgjegjësi të audituesit, tani është përfshirë si pjesë përbërëse e seksionit të ri të Bazës për opinionin.

Ilustrimi 1:

Për qëllime të këtij raporti të audituesit, ilustrues, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- **Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të listuar ose jo, që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600⁶)**
- **Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përpunje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme)**
- **Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.⁷**
- **Audituesi nuk ka vëzhguar numërimin fizik të inventarit në fillim të periudhës aktuale dhe e ka patur të pamundur të marrë evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me tepricat e çeljes së inventarit.**
- **Efektet e mundëshme të pamundësisë për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me tepricat e çeljes të inventarit janë konsideruar të jenë materiale por jo të përhapura për performancën financiare dhe flukset e parave të entitetit.⁸**
- **Pozicioni financiar në fund të vitit është paraqitur në mënyrë të drejtë.**
- **Në këtë juridiksion të veçantë, ligji dhe rregulli e ndalon audituesin të japë një opinion me rezervë në lidhje me performancën financiare dhe flukset e parave dhe një opinion të pa modifikuar lidhur me pozicionin financiar.**

⁶ SNA 600, *Konsiderata të veçanta – Auditimi i pasqyrave financiare të grupit (duke përfshirë punën e audituesit të entitetit të kontrolluar)*

⁷ SNA 210, *Rënia dakord me kushtet e angazhimit të auditimit*

⁸ Nëse efektet e mundëshme sipas gjykimit të audituesit konsiderohen të jenë materiale dhe prekin performancën financiare dhe flukset e parave të entitetit, audituesi do të refuzojë dhënien e një opinioni mbi performancën financiare dhe flukset e parave.

- **Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin, janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).**
- **Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).⁹**
- **Audituesi nuk kërkohet dhe as ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.¹⁰**
- **Audituesi ka siguruar të gjithë informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.**
- **Pasqyrat financiare përmbajnë shifrat korresponduese, dhe pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme u audituan nga audituesi i mëparshëm. Audituesi nuk ndalohet nga ligji ose rregullat të referojë audituesin e mëparshëm në raportin e tij lidhur me shifrat korresponduese dhe ai ka vendosur të veprojë në këtë mënyrë.**
- **Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.**
- **Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).**

⁹ SNA 570 (i rishikuar), *Vijimësia*

¹⁰ SNA 701, *Komunikimi i çështjeve kryesore të auditimit në raportin e audituesit të pavarur.*

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹¹

Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes së përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, dhe performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për opinionin me rezervë

Ne u emëruam auditues të shoqërisë me datën 30 Qershor 20X1, kështu që nuk mundëm të marrim pjesë dhe të vëzhgojmë inventarizimin fizik në fillim të vitit. Ne nuk ishim në gjendje të bindeshim me mjete alternative lidhur me sasitë e inventarit gjendje me datën 31 Dhjetor 20X0. Meqenëse çeljet e inventarit përfshihen në përcaktimin e performancës dhe të flukseve të parasë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të kishin qenë të nevojshme të bëheshin korrigjime, në lidhje me fitimin për vitin, të raportuar në pasqyrën financiare të të ardhurave gjithpërfshirëse dhe flukset neto të parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit, të raportuar në pasqyrën e flukseve të parasë.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAtë). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

Çështje të tjera

¹¹ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset, kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet me datën 31 Dhjetor 20X0, kanë qënë audituar nga një auditues tjetër, i cili me datën 31 Mars 20X1 ka shprehur një opinion pa rezervë mbi këto pasqyra.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull, “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare¹²

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)¹³ – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e audituesit]

[Data]

¹² Në këto raporte auditimi ilustruese termat drejtimi ose personat e ngarkuar me qeverisjen mund të jetë e nevojshme të zëvendësohen nga terma të tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.

¹³ SNA 700 (i rishikuar), *Formimi i një opinionit dhe raportimi mbi pasqyrat financiare*

Ilustrimi 2:

Për qëllime të këtij raporti të audituesit, ilustrues, supozohen rrethanat e mëposhtme:

- Auditimi që kryhet është për një paketë të plotë të pasqyrave financiare të një entiteti të pa listuar që përdor një kuadër të paraqitjes së drejtë. Auditimi nuk është auditim i një grupi (d.m.th. nuk zbatohet SNA 600).
- Pasqyrat financiare janë përgatitur nga drejtimi i entitetit në përputhje me SNRF-të (një kuadër për qëllime të përgjithshme).
- Kushtet e angazhimit të auditimit reflektojnë përshkrimin e përgjegjësisë së drejtimit për pasqyrat financiare, sipas SNA 210.
- Audituesi nuk ka vëzhguar numërimin fizik të inventarit në fillim të periudhës aktuale dhe e ka patur të pamundur të marrë evidencën e auditimit për tepricat e çeljes së inventarit.
- Efektet e mundëshme të pamundësisë për të marrë evidencën e nevojshme të auditimit lidhur me tepricat e çeljes të inventarit të cilat janë konsideruar të jenë materiale por jo të përhapura për performancën financiare dhe flukset e parave të entitetit.¹⁴
- Pozicioni financiar në fund të vitit është paraqitur në mënyrë të drejtë.
- Një opinion i cili është me rezervë lidhur me performancën financiare dhe flukset e parave dhe një opinion i pa modifikuar lidhur me pozicionin financiar i konsideruar i përshtatshëm sipas rrethanave.
- Kërkesat përkatëse etike që zbatohen për auditimin janë ato që janë në fuqi në juridiksionin përkatës (vendin përkatës).
- Bazuar në evidencën e auditimit të siguruar, audituesi ka arritur në përfundimin se nuk ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e entitetit për të vijuar veprimtarinë, sipas SNA 570 (i rishikuar).
- Audituesi nuk kërkohet dhe përndryshe nuk ka vendosur të komunikojë çështjet kryesore të auditimit në pajtim me SNA 701.
- Audituesi ka siguruar të gjithë informacionet e tjera para datës së raportit të audituesit dhe nuk ka identifikuar ndonjë anomali materiale në këto informacione.

¹⁴ Nëse efektet e mundshme sipas gjykimit të audituesit konsiderohen të jenë materiale dhe prekin performancën financiare dhe flukset e parave të entitetit, audituesi do të refuzojë dhënien e një opinionit mbi performancën financiare dhe flukset e parave.

- **Pasqyrat financiare përmbajnë shifrat korresponduese, dhe pasqyrat financiare të periudhës së mëparshme u audituan nga audituesi i mëparshëm. Audituesi nuk ndalohet nga ligji ose rregullat të referojë audituesin e mëparshëm në raportin e audituesit lidhur me shifrat korresponduese dhe ai ka vendosur të veprojë në këtë mënyrë.**
- **Ata që janë përgjegjës për mbikëqyrjen e pasqyrave financiare ndryshojnë nga ata që janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare.**
- **Përveç auditimit të pasqyrave financiare, audituesi ka përgjegjësi të tjera për të raportuar, të cilat kërkohen sipas legjislacionit lokal (të vendit përkatës).**

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Shoqërisë tregtare ABC [ose një adresë tjetër e duhur]

Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare¹⁵**Opinionet**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë tregtare ABC (Shoqëria), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 20X1, pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Opinione me rezervë mbi performancën financiare dhe flukset e parasë

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efekteve të mundshme të çështjes se përshkruar në seksionin e Bazës për Opinionin me Rezervë të raportit tonë, pasqyra financiare e të Ardhurave gjithpërfshirëse dhe pasqyra e flukseve të parasë bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose japin pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) performancën financiare e flukset e parasë për vitin që mbyllet me datën 31 Dhjetor 20X1, në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Opinion mbi pozicionin financiar

Sipas opinionit tonë, pasqyra e pozicionit financiar bashkëlidhur, paraqet drejt, në të gjitha aspektet materiale, (ose jep pamjen e vërtetë dhe të drejtë për) pozicionin financiar të Shoqërisë me datën 31 Dhjetor 20X1, në pajtim me SNRF-të.

Baza për opinionet, përfshirë Bazën për opinionin me rezervë për performancën financiare dhe flukset e parasë

Ne u emëruam auditues të Shoqërisë me datën 30 Qershor 20X1, kështu që nuk mundëm të marrim pjesë dhe të vëzhgojmë inventarizimin fizik në fillim të vitit. Ne nuk ishim në gjendje të bindeshim me mjete alternative lidhur me sasinë e inventarit gjendje me datën 31 Dhjetor 20X0. Meqenëse çeljet e inventarit përfshihen në përcaktimin e performancës dhe flukseve të parasë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktonim nëse do të kishin qenë të nevojshme të bëheshin axhustime në lidhje me fitimin për vitin të raportuar në pasqyrën financiare të të ardhurave gjithpërfshirëse dhe flukset neto të parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit të raportuar në pasqyrën e flukseve të parasë.

Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNAtë). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në

¹⁵ Nëntitulli “Raport mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare” nuk është i nevojshëm të vendoset kur raporti nuk përmban një nëntitull të dytë të emërtuar “Raport mbi Kërkesat e Tjera Ligjore dhe Rregullatore”.

seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare (të zbatueshme në juridiksionin përkatës) dhe kemi përmbushur edhe përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencia e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë pa rezervë për pozicionin financiar dhe për opinionin e auditimit me rezervë për performancën financiare dhe flukset e parasë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin që mbyllet me datën 31 Dhjetor 20X0, kanë qenë audituar nga një auditues tjetër i cili me datën 31 Mars 20X1 ka shprehur një opinion pa rezervë mbi këto pasqyra.

Informacione të tjera [ose një titull tjetër i përshtatshëm, si për shembull “Informacione të tjera të ndryshme nga pasqyrat financiare dhe Raporti i Audituesit mbi to”]

[Raportimi në përputhje me kërkesat e raportimit në SNA 720 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në shtojcën 2 të SNA 720 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen në lidhje me pasqyrat financiare¹⁶

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar)– shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

Raport mbi Kërkesa të tjera Ligjore dhe Rregullatore

[Raportimi në përputhje me SNA 700 (i rishikuar) – shiko Ilustrimin 1 në SNA 700 (i rishikuar).]

[Nënshkrimi, në emër të firmës së auditimit, emrin personal të audituesit ose të dyja bashkë, cilado është e përshtatshme në juridiksionin e caktuar]

[Adresa e Audituesit]

[Data]

¹⁶ Ose terma te tjerë që janë të përshtatshëm në kontekstin e kuadrit ligjor që zbatohet në një juridiksion të caktuar.